

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË MINISTRINË E SHËNDETËSISË PËR PROJEKTIN “REHABILITIMI DHE PAJISJA E PESË POLIKLINIKAVE”

Raporti përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Ministrinë e Shëndetësisë për Projektin “Rehabilitimi dhe pajisja e pesë poliklinikave” me objekt “Mbi zbatimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare” për periudhën e veprimtarisë nga fillimi i projektit deri me datë 31.03.2015 dhe masat për përmirësimin e gjendjes janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr.73, datë 30.06.2015.

Bazuar në nenet 15 dhe 16 të ligjit nr.154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, me shkresën nr. 403/8, datë 30.06.2015, dërguar z. Ilir Beqaj, Ministër i Shëndetësisë, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. -Ministria e Shëndetësisë, nuk ka dërguar përgjigje zyrtare brenda afatit kohor të përcaktuar 20 ditë nga dërgimi i rekomandimeve dhe raportit përfundimtar i KLSH, për auditimin e mëparshëm të kryer për projektin “Rehabilitimi dhe pajisja e pesë poliklinikave”.

-Nga gjashtë masa organizative të rekomanduar, tre masa janë zbatuar plotësisht dhe tre masa nuk janë zbatuar. Nga tre masa shpërblim dëmi, të rekomanduara një masë është zbatuar plotësisht, dy masa janë zbatuar pjesërisht. Masa administrative të rekomanduara për dy persona, nuk janë zbatuar. Masa disiplinore, e rekomanduar për një punonjës nuk është zbatuar.

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Ministria e Shëndetësisë, të marri masa për zbatimin dhe përmbushjen e të gjitha masave dhe rekomandimeve të parealizuar, të lëna nga auditimi i mëparshëm. Këto masa të realizohen në përputhje me programin e punës të hartuar dhe miratuar nga Ministri i Shëndetësisë dhe Sekretari i Përgjithshëm, “Për zbatimin e rekomandimeve të KLSH”, ku janë përcaktuar afate edhe drejtoritë përkatëse për ndjekjen e tyre.

Menjëherë

2. -Afati i përfundimit të periudhës së disbursimeve për projektin “Rehabilitimi dhe pajisja e pesë poliklinikave”, pas shtyrjes së miratuar ka qenë në qershor të vitit 2011. Me shkresën nr. 14435, datë 15.07.2011, të Ministrisë së Financave, është përcjell në MSH njoftimi i Artigianccasa mbi shtyrjen e afatit të disbursimeve deri më datë 04.08.2012. Shkresa e Artigianccasa për miratimin e shtyrjes është e datës 13.07.2011.

Në fakt afati i shtyrë i disbursimeve ka përfunduar më datë 04.08.2012, por nga Ministria e Shëndetësisë, nuk janë zbatuar rregullat dhe hapat që duhet të ndiqen për një shtyrje të dytë dhe miratimin e periudhës së re të disbursimeve.

-Me shkresë nr. 12768, datë 8.08.2012, të Ministrisë së Financave ka njoftuar MSH dhe i ka kujtuar se afati i kryerjes së disbursimeve ka përfunduar që më datë 04.08.2012. Gjithashtu, është theksuar që të kërkohet urgjent shtyrja e afatit duke i përcjellë MF bashkëlidhur edhe argumentimin dhe arsyet e vonësive që kanë shkaktuar mos dirbursimin e kredisë brenda afatit të përcaktuar në marrëveshje, por nga PIU/MSH nuk është ndërmarr asnjë veprim.

-Në korrespondencë që MSH ka me MF, nuk u gjet asnjë kërkesë zyrtare drejtuar MF për shtyrje të afatit të disbursimit për vitin 2012 deri në fund të vitit 2013, periudhe në të cilën kredia e butë ka qenë inaktive dhe për shkak të mos shtyrjes së periudhës së disbursimeve nuk mund të kryhej asnjë pagesë, veprime të cilat janë në kundërshtim me nenet 4 dhe 8 të Marrëveshjes financiar dhe me nenin 4 të Marrëveshjes së kredisë.

-Me shkresën nr. 4446/2, datë 1.11.2013, të MSH është bërë kërkesa për shtyrje të afatit të disbursimeve për kreditë, për arsye se janë lidhur kontratat për furnizimin me pajisje mjekësor të tre poliklinikave Tirana nr. 2 dhe nr. 3, dhe poliklinikën e Korçës, por në shkresë nuk është dhënë shpjegim mbi statusin e projektit, nuk janë sqaruar dhe nuk janë dhënë arsyet e vonësës së projektit dhe moszbatimit të afatit të disbursimeve, nuk është përcaktuar se kush do të jetë afati i ri i disbursimeve dhe afati i përfundimit të projektit.

-Nga auditimi u konstatua se nuk ka shkresë nga Artigiancassa për miratim të shtyrjes së disbursimeve, veprim ky në kundërshtim me nenin 4 të Marrëveshjes financiare.

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Njësia e Zbatimit të Projektit//Ministria e Shëndetësisë, të marri masa për të zbatuar rregullat dhe hapat që duhet të ndiqen për shtyrjen dhe miratimin e periudhës së disbursimeve, për projektin “Rehabilitimi dhe pajisja e pesë poliklinikave”. Kërkesat për shtyrje të periudhës së disbursimit duhet të bëhen brenda afateve të përcaktuara në Marrëveshjen financiare, si dhe të merret miratimi i donatorit Artigiancassa, për arsye se në dy raste kur ka qenë e nevojshme shtyrja e afatit të disbursimeve të kredisë së butë, MSH nuk ka zbatuar marrëveshjen financiare për këtë procedura, veprim ky që ka sjell mos aktivizim të kredisë për një periudhë disavjeçare.

Menjëherë

3. -Në dokumentet e projektit mungon ose nuk është i plotë, si dhe nuk është mbledhur dhe sistemuar i gjithë dokumentacioni financiar i projektit, veprime këto në kundërshtim me neni 6 të marrëveshjes financiare. Kjo situatë e ka bërë të pamundur evidentimin e saktë të bilancit dhe gjendjes aktuale të financave të projektit.

-Mungon dokumentacioni financiar i pagesave të bëra në përputhje me përcaktim e bërë në nenet 6 dhe 7 të Marrëveshjes financiare, pjesa e dokumentacionit që gjendet është e pa arkivuara.

-Nga Njësitë e Zbatimit të Projektit të ngritura për koordinimin e funksioneve të natyrës teknike dhe menaxhuese të nevojshme për realizimin e projektit, nuk është bërë një pasqyrë e gjendjes së disbursimit, mungojnë tabelat financiare ku të pasqyrohet shkalla e realizimit të disbursimeve të kredisë, të likuidimit të kontratave të lidhura.

-Nga auditimi rezulton një ngecje/stopim i projektit në menaxhimin financiar, si dhe një mosrealizim i theksuar i nivelit të disbursimit të kredisë.

-Nuk ka raportime financiar dhe nuk shpjegohen dhe argumentohen arsyet e stopimit të disbursimeve të projektit. NJZP nuk ishte në gjendje të na paraqiste një pasqyrë të qartë financiare të projektit.

-Për projektin nuk janë mbajtur evidenca të sakta kontabël dhe financiare, nuk është bërë kontroll i dokumentacionit të dorëzuar nga një PIU të tjetri, nuk është bërë rakordim me bankën agjente shqiptare për disbursimet e kryera.

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Njësia e Zbatimit të Projektit//Ministria e Shëndetësisë, të marri masa të menjëhershme për grumbullimin, sistemin dhe evidentimin e të gjithë dokumentacionit financiar për projektin “Rehabilitimi dhe pajisja e pesë poliklinikave”, për periudhën nga fillimi i zbatimit deri në përfundimin e tij, me qëllim evidentimin e saktë të gjendjes aktuale financiare të projektit, si dhe të mbahen evidenca të sakta kontabile dhe të behën rakordime periodike të rregullta me bankën agjente shqiptare.

Gjithashtu, të merren masa për t’u bërë një analizë e hollësishme financiare, me qëllim argumentimin dhe nxjerrjen e përgjegjësive për mosrealizimin dhe përmbushjen e menaxhimit financiar të projektit.

Menjëherë

4. -Nga auditimi në lidhje me shumën e disbursuar të kredisë së butë, u konstatua se nga fillimi i vitit 2010 deri më datë 31.03.2015, ka vetëm një kërkesë për disbursim, kërkesë

e cila ka të bëj me likuidimin e situacionit të fundit të kontratës për “Rehabilitimin e poliklinikës së Korçës” të lidhur më datë 13.06.2008.

-Disbursimet e huasë janë bërë vetëm në periudhën vitet 2008-2010 dhe nga viti 2011 deri në viti 2014, kredisë ka “fjetur” dhe nuk është kryer asnjë disbursim, situatë e cila tregon se kredisë për projektin e ka humbur qëllimin për të cilën është akorduar dhe për atë çfarë pala shqiptare ka marrë përsipër për të plotësuar. Ka mbetur pa u disbursuar shuma 3,340,684 euro e kredisë së butë ose 66% e saj. Përqindja e kredisë së disbursuar është 34% dhe kjo e shpërndarë në tre vite e para të projektit.

-Nga të dhënat për disbursimet u konstatua mos përputhje dhe mos kuadrim të shifrave të disbursimit në vite dhe kjo për arsye se nga viti 2010 deri në vitin 2014 shuma në totale disbursimeve të raportuara nga PIU është 204,007 euro, ndërsa në fakt me dokumente dhe me kërkesë disbursimi është vetëm një pagesë, ajo e situacionit të fundit për rehabilitimin e poliklinikës së Korçës në shumën 21,743 euro, për pjesën tjetër 185,264 euro nuk ka asnjë dokumentacion apo kërkesë disbursimi në PIU/MSH.

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Njësia e Zbatimit të Projektit//Ministria e Shëndetësisë, të marri masa të menjëhershme për fillimin dhe shpalljen e procedurës së garave (tenderimit), për dy objektet, poliklinikat Gjirokastër dhe Peshkopi, me qëllim përmbushjen e objektivave të projektit dhe me synim parandalimin e rritjes së mëtejshme të kostos së riparimit të tyre, dhe vënien në eficientë të plotë të tyre.

Menjëherë

5.- Grupi i auditimit nëpërmjet shkresës nr. 1800/2, datë 24.04.2015 të Sekretarit të Përgjithshëm të MSH, ka kërkuar në MF informacion, për pagesat e interesit të paguara për kredinë e butë, të akorduar për projektin “Rehabilitimi dhe pajisja e pesë poliklinikave”. Me shkresën nr. 6562, datë 30.04.2015, të Sekretarit të Përgjithshëm të MF janë përcjellë të dhënat mbi pagesat e interesit. Nga verifikimi i të dhënave, u konstatua se për periudhën 2009-2011, shuma e pagesave për interesin e shumave të disbursuara të kredisë është 3,384 euro. Gjithashtu, për kredinë e butë për periudhën 2012-2015, janë paguar në total interesa në shumën 6,213 euro. Këto interesa të cilat janë paguar për një periudhë ku sipas marrëveshjes së kredisë dhe asaj financiare, projekti duhet të kishte përfunduar, për më tepër për periudhë 2012-2015, është paguar interes ndonëse nuk është zhvilluar dhe realizuar asnjë nga aktivitetet dhe komponentët e projektit. Për sa më lart rezulton se shuma **6,213 euro** ka rënduar me të padrejtë koston e kredisë dhe ka sjell një efekt negativ në buxhetin e shtetit.

Për sa më sipër rekomandojmë:

- Njësia e Zbatimit të Projektit//Ministria e Shëndetësisë, të marri masa për të saktësuar, regjistruar dhe plotësuar me dokumentacionin e plotë justifikues, për shumën e disbursuar në vlerën 185,264 euro, për projektin “Rehabilitimi dhe pajisja e pesë poliklinikave”, me qëllim që të evidentohet se për cilin nga komponent e projektit janë bërë kërkesat për disbursim.

Menjëherë

6. - Për komponentin “Rehabilitimi i pesë poliklinikave”. Realizimi i disbursimit është në shumën 1,674,665 euro ose në masën 82% të shumës së përcaktuar në marrëveshje për këtë komponent. Janë realizuar rehabilitimet e tre poliklinikave, ndërsa për dy poliklinikat Gjirokastër dhe Peshkopi ende nuk ka filluar rehabilitimi.

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Njësia e Zbatimit të Projektit//Ministria e Shëndetësisë, të marri masa të menjëhershme për realizimin dhe përfundimin e projektit “Rehabilitimi dhe pajisja e pesë poliklinikave”, brenda një kohe të arsyeshme, me qëllim që bëj dhe minimizimin e interesave të paguara për pjesën e pa tërhequr të kredisë, për arsye se për periudhën kur projekti ka stopuar janë

paguar interesa në shumë **6,213 euro**, duke rënduar me të padrejtë koston e kredisë dhe duke sjell një efekt negativ në buxhetin e shtetit.

Menjëherë

7. -Për komponentin “Sigurimi i pajisjeve për poliklinikat”, financimi i të cilit zë 60% të vlerës totale të kredisë, konstatohet se deri në vitin 2012, nuk ishte lidhur kontrata për furnizimin me pajisje. Procedura e prokurimit për sigurimin e pajisjeve ka përfunduar në vitin 2013 dhe janë lidhur 4 kontrata më datë 10.10.2013, për furnizim vendosje pajisje mjekësore për poliklinikat nr. 2 dhe nr. 3 në Tiranë dhe poliklinikë në Korçë, si dhe pajisje me mobileje për këto tre poliklinika. Ndonëse kontratat janë lidhur në tetor 2013, nga auditimi u konstatua se ende nuk kanë përfunduar, dhe nuk është bërë asnjë disbursim për likuidimin e tyre. Ndërsa sigurimi i pajisjeve për poliklinikat, në qytetet Gjirokastrë dhe Peshkopë, nuk është bërë, për vetë faktin se për dy poliklinikat nuk ka filluar ende rehabilitimi.

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Njësia e Zbatimit të Projektit/Ministria e Shëndetësisë të merren masa që paralelisht me shpalljen e garave (tenderëve) për rikonstruksionin e dy poliklinikave në qytetet Gjirokastrë dhe Peshkopë, të bëjë edhe përgatitjen e dokumenteve dhe hapja e garave për furnizimin e dy poliklinikave me mobile dhe pajisje mjekësore, për arsye se ka kaluar më shumë se 10 vjet nga nisja e zbatimit të projektit dhe ende nuk është nisur procedura. Gjithashtu, me fillimin e garës për rehabilitimin e dy poliklinikave, të llogaritet dhe afati për përfundimin dhe realizimin e procedurës për furnizimin me pajisje të dy poliklinikave, me qëllim që me përfundimin e punimeve të ndërtimit të bëhet dhe instalimi i pajisjeve.

Menjëherë

8. -Për komponentin “Projektimi dhe supervizimi”, është parashikuar nga kredia shumë 189,329 euro dhe ky është aktiviteti i parë i tenderuar nga NJZP. Për këtë shërbim më datë 11.10.2007 është lidhur kontrata me kompaninë , me objekt “Për shërbimin e supervizionit të punimeve dhe furnizimi me pajisje”, më vlerë bazë 117,350 euro. Me shkresë nr. 513/6 prot., datë 22.01.2011, shoqëria, ka kërkuar dorëheqjen nga kryerja e shërbimeve.

Me shkresën nr. 013/7, datë 13.07.2012 Sekretarës së Përgjithshme të MSH, drejtuar drejtorit të Drejtorisë Juridike, është kërkuar dhënia e asistencës teknike për shoqërinë, për tërheqjen e saj në datë 15.03.2011, por më datë 15.03.2011 (pas 18 muajve) shoqëria me një shkresë të dytë ka kërkuar rikthimin. Në fakt nga verifikimi i datave dhe nga kronologjia e veprimeve, nuk shpjegohet se si në kërkesën e datës 13.07.2012 (viti i korrigjuar), është cituar shkresa e rikthimit të shoqërisë, kur realisht kjo shkresë mban datën 03.09.2012 dhe si datë të hyrjes në protokoll të MSH datën 13.09.2012.

-Nga drejtori i Drejtorisë Juridike në MSH është kthyer përgjigje me një memo pa datë dhe pa numër protokoll, me të cilën nuk është dhënë asnjë mendim tekniko-juridik, por vetëm se është bërë një pasqyrim i shkurtë i marrëdhënies kontraktuale me shoqërinë Periudhës së tërheqjes së supervizorit prej 18 muajve, nuk i është dhënë asnjë shpjegim.

-Pas 18 muajve nga data e njoftimit të dorëheqjes, shoqëria , me shkresën nr. 3650/7, datë 13.09.2012, ka njoftuar thjesht se është e gatshme të vazhdojë kryerjen e shërbimit në përputhje me kontratën e lidhur në tetor 2007. Në shkresë nuk është dhënë asnjë shpjegim për rikthimin dhe revokimin nga dorëheqja e parrevokueshme e datës 15.03.2011.

-Nga auditimi u konstatua se nga data e rikthimit të shoqërisë së supervizionit dhe deri në momentin e auditimit, afërsisht për një periudhë 3 vjeçare, shoqëria nuk ka

kryer asnjë shërbim dhe nuk ka përmbushur asnjë detyrim që rrjedh nga kontrata, kjo për arsye se për këtë periudhë nuk ka filluar rehabilitimi i dy poliklinikave Gjirokastër dhe Peshkopi, madje theksojmë se procedura e garës për rikonstruksionin e këtyre dy poliklinikave nuk është shpallur asnjëherë.

-Ndërprerja e shërbimit të konsulencës nga ana e Konsulentit ka shkaktuar bllokimin e procesit të tenderimit dhe të punimeve për Poliklinikën e Gjirokastrës dhe atë të Peshkopisë. Nga ana e Ministrisë nuk janë marrë masat e duhura për zbatimin e detyrimeve të kontratës.

Si përfundim nga auditimi i kësaj kontrate arrihet në konfuzionin se:

-Ndërprerja e njëanshme e kontratës nga ana e Shoqërisë, ka shkaktuar vonesa të theksuara në zbatimin e projektit.

Poliklinikat e Peshkopisë dhe Gjirokastrës nuk i janë nënshtruar rikonstruksionit në kohë, duke mos arritur qëllimin e përcaktuar në marrëveshjen e financimit.

Mos rikonstruksioni në kohë i këtyre objekteve do të rrisë koston e punimeve.

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Ministria e Shëndetësisë dhe Njësia e Zbatimit të Projektit, në përputhje me nenin 18, të kontratës së konsulencës, të marrin masa dhe të kërkojnë në rrugë ligjore konfiskimin e garancisë së kontratës së shërbimeve konsulte Shoqërisë, me vlerë 11,735 Euro, për ndërprerje të njëanshme të shërbimeve konsulte.

Menjëherë

9. -Projekti ka nisur në vitin 2004, dhe në korrik të këtij viti është bërë aktive kredia e butë. Nga fillimi i projektit deri në momentin e auditimit ka kaluar një periudhë më shumë se 10 vjet dhe rezultati i arritur nga projekti është i pjesshëm dhe i ndarë në përpjesëtim të zhdrejtë në vite.

Asnjë nga aktivitetet/komponentët e projektit nuk është realizuar në masën 100%.

-Për periudhën nga viti 2010 deri në momentin e auditimit nuk është realizuar asnjë aktivitet për projektin, në vitin 2013 është zhvilluar vetëm procedura për tenderin e sigurimit të pajisjeve dhe janë lidhur katër kontrata, të cilat janë në proces.

-Palët përgjegjëse për zbatimin e projektit, Cooperacione Italiane dhe MSH, nuk kanë përcaktuar një afat për përfundimin e projektit, si dhe një grafik kohe për jetëgjatësinë dhe ecurinë në vite. Nuk është hartuar një dokument i vlerësimit të projektit, veprime të cilat kanë sjellë një zvarritje të tij (projektit).

-Midis dy palëve MSH dhe palës italiane, për stopimin e projektit nuk është bërë një riaktivizim i kredisë, si dhe nuk është hartuar një program që cakton radhën e veprimeve në vazhdimësi, veprim këto në kundërshtim me nenin 11 të Marrëveshjes së kredisë, ku përcaktohet se nëse zgjatja e pengesave është më e madhe se 24 muaj, palët janë të detyruara të bien dakord mbi vazhdimin e projektit dhe të caktojnë radhën e veprimeve.

-Nga situata dhe nga ecuria e projektit, mund të gjykojmë se ky projekt është i dështuar, për arsye se ai nuk i ka përmbushur tre treguesit kryesore që duhet të ketë një projekt që janë: ekonomiciteti, koha e implementimit dhe arritjet/rezultate e prekshme, tregues të cilët duhet të jenë në raport të drejtë me njëri -tjetrin.

-Projekti, nuk ka përmbushur si objektivin e përgjithshëm edhe objektivat specifike, duke bërë të pamundurën realizimin e objektivit të dyfishtë nga njëra anë kontributin për përmirësimin e kushteve të shëndetit të popullsisë përftuese dhe nga ana tjetër optimizmin e koston së menaxhimit të sistemit. Nuk është mundur të përmirësohet dhënien e shërbimit shëndetësor në 5 poliklinikat, referuar kualitetit dhe mbulimit të zonës ku jepet ky shërbim.

Për sa më sipër rekomandojmë:

- Ministria e Shëndetësisë dhe Njësia e Zbatimit të Projektit, të marri masa të menjëhershme për përshpejtimin e veprimtarisë, me qëllim përfundimin dhe realizimin e

plotë të të gjitha komponentëve të programit, për arsye se ka kaluar një kohë shumë e gjatë nga afati i përcaktuar për përfundimin e projektit, si dhe të hartohet një plan veprimi, ku të përcaktohet radha e veprimeve, grafiku kohori vazhdimësisë së projektit dhe afati përfundimtar i projektit, me qëllim që të arrihet përmbushja e parimit të 3 E-ve, ekonomikitetit, efikasitetit dhe eficiencës për këtë projekt.

Menjëherë

10. Arsyet kryesore të ndalimit për tre vite të projektit dhe zbatimit të ngadaltë të tij janë si më poshtë:

-Në MSH për realizimin dhe ndjekjen e projektit nuk është ngritur që në fillim të zbatimit të tij Njësia e Zbatimit të Projektit, në përputhje me përcaktimin e bërë në Marrëveshjen e kredisë, ku PIU i ngritur pranë MSH-se duhet të kujdeset për koordinimin e funksioneve të natyrës teknike dhe menaxhuese të nevojshme për realizimin e programit.

-Ndryshimet e shpeshta të NJZP si në formë dhe në përmbajtje, për projektin ndër vite. Krijimi i katër NJZP-ve, ku një njësi ka funksionuar vetëm dy muaj, ka sjellë një boshllëk në dokumentimin e zhvillimit të fazave të projektit, në ruajtjen e dokumentacionit, dhe në ndjekjen dhe monitorimin e projektit në përputhje me përcaktimet e sanksionuar në Marrëveshjen e kredisë.

-Ndryshimi permanent i stafit drejtues të MSH, ka sjellë një boshllëk në bërjen operative të veprimeve, aktiviteteve dhe akteve formale të nevojshëm për ecurinë e mirë të projektit.

-MSH dhe PIU/MSH, nuk kanë bërë një analizë të hollësishme ku të përcaktohen shkaqet dhe përgjegjësitë për situatën dhe performancën tepër të dobët të ecurisë së projektit, si dhe masat që duhet të merren për përfundimin sa më të shpejt të projektit.

-MSH dhe MAE/DGCS, nuk kanë bërë asnjë monitorim periodik të përbashkët për ecurinë e projektin, në përputhje me përcaktimin e sanksionuar në Marrëveshjen e kredisë.

-Pengesat për realizimin e projektit kanë ardhur si pasojë e palës shqiptare, Ministrisë së Shëndetësisë, e cila nuk ka mundur të plotësojë detyrimet që i ka përcaktuar Marrëveshja e kredisë, nuk ka mundur të zhvillojë e të bëjë operative aktivitetet e projektit brenda afatit të përcaktuar në Marrëveshjen e kredisë. Pengesat për realizimin e projektit, nuk janë të përcaktuara në Marrëveshjen e kredisë, e cila si pengesa për realizimin e projektit rendit pengesat e ardhura për shkak të forcave madhore (luftëra, përmbytje, zjarr, konflikte pune, greva, vendime të secilës qeveri etj.)

Për sa më lart rekomandojmë:

- Ministria e Shëndetësisë dhe Njësia e Zbatimit të Projektit, të marri masa për hartimin e një raporti ku të përcaktohen me hollësi shkaqet, arsyet dhe të jepen argumentet për vonesën e realizimit të projektit, si dhe të nxirren përgjegjësitë përkatëse dhe të përcaktohen masat e nevojshme për përfundimin e gjithë aktiviteteve të projektit.

Menjëherë

11. -Për furnizimin me pajisje dhe mobilim të poliklinikës 2 dhe 3 në Tiranë dhe Poliklinikës së Korçës, gjatë vitit 2013, janë zhvilluar dy tenderë me nga dy lote. Lotet përfshijnë furnizimin e pajisjeve mjekësore dhe mobilimin.

Zbatimi i kontratave të furnizimit të poliklinikave nuk ka filluar pas nënshkrimit të tyre, për arsye se më parë kërkohej miratimi nga Artigiancassa S.p.a, sipas përcaktimeve në Pikën 6.4 të marrëveshjes.

-Miratimi sipas kërkesës së mësipërme nga Artigiancassa, duke i'u referuar nënshkrimit të kontratave, ka kërkuar një kohë të konsiderueshme, e cila ka zgjatur nga një vit deri në 1 vit e gjysmë. Çdo vonesë në implementimin e këtyre kontratave është vonesë e futjes në eficiencë të poliklinikave, rrjedhimisht vonesë në ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.

Për sa më lart rekomandojmë:

Ministria e Shëndetësisë, për kontratat e ardhshme të furnizimit të poliklinikave të marrë masat e duhura, duke kërkuar nga Artigiancassa, miratimin në një kohë sa më të shkurtër të fillimit të implementimit të tyre, me qëllim futjen sa më shpejt në eficiencë të poliklinikave duke ofruar shërbimin e duhur ndaj qytetarëve.

Menjëherë

B. Pavarësisht se zbatimi i Projektit ka shumë mangësi, të cilat nuk janë evidentuar në dy auditimet e kryera, KLSH bazuar në vendimin e Kryetarit do të organizojmë Auditim Performance për këtë projekt, me qëllim evidentimin e problematikave dhe mangësive që kanë shoqëruar zbatimin e tij, duke rekomanduar marrjen e masave për përmirësimin e zbatimit të këtij Projekti.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Yllka Pulashi, Artan Topjana, Lavdie Fshazi dhe Odeon Smajli, më tej u shqyrtua nga k/auditues Fatmir Iliazi, Drejtori i Departamentit Xhaferr Xhoxhaj, Drejtori i Departamentit Juridike dhe Sigurimit të Standardeve Ermal Yzeiraj.